**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
DREJTORIA E LIGJSHMËRISË
Sektori i Hartimit të Akteve

Tiranë më 16.12.2024

Nr. 3548

**RELACION**
**PËR**
**PROJEKTVENDIMIN**
**PËR**
**RREGULLAT E RAPORTIMIT TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE NË PERIUDHËN ZGJEDHORE NGA ANA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE**

## I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 10019, date 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjensive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara përgjatë fushatës, si dhe procedurën e KQZ-së për zbatimin e ndalimit.

Në nenin 92 të Kodit Zgjedhor parashikohet detyrimi i institucioneve publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjensive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, për të raportuar në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta shqyrtuar.

## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKVENDIMIT

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektvendimi "Për rregullat e raportimit të veprimtarive publike në periudhën zgjedhore nga ana e institucioneve publike".

Ky akt ka për qëllim të vendosë rregulla më të qarta dhe më të plota për procedurën e raportimit nga institucionet publike të veprimtarive të tyre gjatë periudhës nga 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

Akti është hartuar në 5 (pesë) krerë, ku në kreun I përcaktohet qëllimi, përkufizimet dhe rregulla të përgjithshme; kreu II parashikon regjistrimin e subjekteve në ndërfaqen elektronike të raportimit të institucioneve (NRI); kreu III përshkruan procedurën e raportimit në NRI; Kreu IV përcakton shqyrtimin e raportimeve; kurse kreu V dispozita të fundit.

Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjensitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Në referim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që

janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjensive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

Raportimi kryhet nëpërmjet ndërfaqes për raportimin e veprimtarive publike, e cila mbahet dhe administrohet nga KQZ-ja. Personat përgjegjës marrin akses të personalizuar te kjo ndërfaqe dhe hedhin të dhënat për datën dhe orën e veprimtarisë, llojin e saj, tematikën, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin. Informacioni sipas kësaj pike është i aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit e ndërfaqes nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në rast se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton nga informacioni, se veprimtaria mund të përbëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron ndalimin e zhvillimit të saj.

Rregullat për shqyrtimin, kryesisht ose me kërkesë, të rasteve që mund të formojnë keqpërdorim të burimeve shtetërore, miratohen nga KQZ-ja me akt normativ.

"NRI" është ndërfaqja elektronike e raportimeve të institucioneve publike e cila ndërtohet dhe shërben sipas përcaktimeve të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Raportimi i veprimtarive publike bëhet në KQZ nëpërmjet NRI e cila ndërtohet dhe mirëmbahet nga ky institucion.

Të dhënat mbi aktivetet publike të administratës shtetërore, apo të institucioneve publike duhet të jenë të akesueshme,"open data," për këdo të tretë, direkt nga NRI, duke patur mundësinë e prodhimit të raporteve përkatëse. Informacioni që përmban NRI është i aksesueshëm nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Raportimi në NRI për një veprimtari publike të caktuar duhet të bëhet jo më vonë se 5 ditë përpara datës së planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Raportimi bëhet për veprimtari të cilat organizohen, ose bashkëorganizohen nga institucioni publik raportues. Nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë.

NRI mund të lejojë raportimin e një veprimtarie e cila nuk plotëson kushtin e cituar më sipër, por automatikisht kjo veprimtari përcaktohet si e ndaluar për sa kohë KSHZ nuk ka marrë një vendim për ta lejuar atë.

Raportimi duhet të përmbajë datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë, qarkun, bashkinë adresën ku ajo zhvillohet, llojin e saj, tematikën e veprimtarisë, emër mbiemër të personave pjesmarrës të cilët përfaqësojnë nivelin më të lartë hierarkik shtetëror në aktivitetin përkatës, institucionin të cilit i përkasin, emër mbiemër të folësve të mundshëm dhe pozicionin e tyre, me pjesmarrje të medias ose jo, pasqyruar në rrjete sociale, median online, ose jo.

Të dhënat e raportimit nuk mund të modifikohen në periudhën 5 ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit deri në datën e zhvillimit të tij.

KQZ shqyrton raportimet e institucioneve si rregull jo më vonë se 3 ditë nga raportimi i tyre në NRI. Në rast se KQZ, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton se veprimtaria ose aktiviteti publik përbën veprimtari të ndaluar urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë ose aktivitetit publik përkatës. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit "Ndaluar nga KQZ-ja" në NRI, në pjesën që i takon veprimtarisë. Njoftimi për ndalim i shkon automatikisht institucionit në llogarinë e tij në NRI.

Personat e tretë që paraqesin kërkesën në KQZ për të kërkuar ndalimin e një veprimtarie apo aktiviteti publik, duhet ta paraqesin atë jo më vonë se tre ditë nga data e planifikuar e mbajtjes të tij. Kërkesa paraqitet në protokollin e KQZ ose nëpërmjet adresës zyrtare të e-mailit dhe duhet të jetë e arsyetuar. KQZ shqyrton kërkesën dhe vendos në lidhje me të brenda 24 orësh nga paraqitja e saj.

Për veprimtarinë ose aktivitetin publik "Ndaluar nga KQZ-ja", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton menjëherë zyrtarisht edhe Autoritetin e Mediave Audiovizive. Veprimtaritë e ndaluara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk lejohet të transmetohen apo të pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me ndalimin e vendosur nga Komisioneri ngarkon me përgjegjësi sipas këtij ligji transmetuesin radioteleviziv.

Mosraportimi i një veprimtarie publike, ose raportimi i saj në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë vendim, apo akte të tjera, apo pengimi për raportimin, ngarkon me përgjegjësi personi përkatës në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Shqyrtimi administrativ në këtë rast bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe aktet e KQZ.

Dispozitat e Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, "*Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjensive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*", vetëm në lidhje me raportimin e veprimtarive publike të institucioneve publike, shfuqizohen.

Në vijim të praktikës që ndjek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për konsultimin paraprak të projektakteve, në përgjigje të email-it të datës 13 dhjetor 2024, Komisioni për Reformë, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ka dërguar më datë 17.12.2024, rekomandime lidhur me modulin e ri të raportimit të institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore që kanë detyrimin të raportojnë të gjitha veprimtaritë që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve.

Sugjerimet e KRIIK janë të bazuara, kryesisht, në problematikat që janë vëzhguar në zgjedhjet e kryera në vend që nga momenti kur ndërfaqja ka nisur fillimisht të përdoret (2021), përfshi gjithë zgjedhjet që janë mbajtur nga ai moment, qofshin këto të përgjithshme, të pjesshme apo të përsëritura, si dhe disa sugjerime më teknike që gjykohet se i shërbejnë kuptimit më të mirë të aktivitetit si dhe plotësimit të informacionit që përcillet sipas nenit 4 pika 3 të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Disa nga këto rekomandime janë marrë në konsideratë dhe sugjerimet teknike janë reflektuar në modul.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin "Për rregullat e raportimit të veprimtarive publike në periudhën zgjedhore nga ana e institucioneve publike".

**Pavlina DOÇAJ** - Drejtoria e Ligjshmërisë

**Majlinda ÇELMETA** - Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**
**KOMISIONI RREGULLATOR**

| | | |
|---|---|---|
| Data: DD MM VVVV | Nr: 000-000 | Ora: HH:MM |

# VENDIM

# PËR

# RREGULLAT E RAPORTIMIT TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE NË PERIUDHËN ZGJEDHORE NGA ANA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja "c" dhe nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni Rregullator

**V E N D O S I:**

## KREU 1

## QËLLIMI, PËRKUFIZIME DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Ky akt ka për qëllim të vendosë rregulla për raportimin nga institucionet publike të veprimtarive të tyre gjatë periudhës 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.
2. Subjekte të këtij vendimi janë institucionet publike dhe administrata shtetërore sipas përkufizimeve vijuese.
3. Për efekt të këtij vendimi do të përkufizohen:
   a) "Institucion publik", çdo organ apo ent publik në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.
   b) "Administratë shtetërore":
      i. administrata nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sipas nenit 1, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", ku përfshihen institucionet e përmendura në pikën 2, të nenit 4, të këtij ligji.
      ii. punonjës të administratës shtetërore, ndaj të cilëve zbatohet ky vendim, sipas statusit të tyre, janë nëpunës civilë dhe punonjës administrativë, në përputhje me përkufizimet e dhëna në nenin 4, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë civilë, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës;
      iii. punonjës policie, punonjës të shërbimit të jashtëm, të përmendur në nenin 3, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë, statusi i të cilëve ose elemente të tjerë rregullohen me ligje të posaçme, ndaj të cilëve, përveç dispozitave të përgjithshme të këtij vendimi, do të zbatohen edhe dispozitat e veçanta për secilën prej kategorive të përmendura, për çdo rast, në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë vendim.

c) “Veprimtari publike” janë të gjitha veprimtaritë dhe aktivitetet që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut dhe/ose të medias, ose pasqyrohen nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit dhe të informimit publik, si të tilla por pa u kufizuar, media online, rrjete sociale, faqe interneti, etj, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim. Janë gjithashtu veprimtari të tilla dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

ç) “Veprimtari e ndaluar” është veprimtaria e institucionit publik e përcaktuar si e tillë nga vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjensive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore përpara zgjedhjeve.

d) “Kodi Zgjedhor” është ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

dh) “KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

e) “KSHZ” është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

ë) “NRI” është ndërfaqja elektronike e raportimeve të institucioneve publike e cila ndërtohet dhe shërben sipas përcaktimeve të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

f) “Personi përgjegjës për raportimin” është Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, sekretari i përgjithshëm i ministrisë, nëpunësi me hierarkinë më të lartë në bashki, drejtori i përgjithshëm apo drejtuesi më i lartë administrativ për agjensitë dhe institucionet nën varësinë e Këshillit të Ministrave, drejtuesi ekzekutiv i shoqërive tregtare në të cilat shteti ka pjesëmarrje në më shumë se 50 përqind të aksioneve, drejtuesi ekzekutiv i ndërmarrjeve shtetërore.

g) “Raportim” është veprimi i informimit të KQZ nga institucioni publik mbi veprimtarinë publike të këtij të fundit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

4. Veprimtaria publike duhet të raportohet nga personi përgjegjës për raportimin, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.
5. Raportimi i veprimtarive publike bëhet në KQZ nëpërmjet NRI e cila ndërtohet dhe mirëmbahet nga ky institucion.
6. Të dhënat mbi aktivetet publike të administratës shtetërore, apo të institucioneve publike duhet të jenë të akesueshme,*“open data,”* për këdo të tretë, direkt nga NRI, duke patur mundësinë e prodhimit të raporteve përkatëse. Informacioni që përmban NRI është i aksesueshëm nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

## KREU II
## REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE NË NDËRFAQEN ELEKTRONIKE TË RAPORTIMIT TË INSTITUCIONEVE (NRI)

1. Ndërfaqja Elektronike e Raportimit të Institucioneve (NRI) përfaqëson faqen zyrtare të internetit të zotëruar dhe në shërbim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe të institucioneve të tjera për ushtrimin e detyrave e të përgjegjësive ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë vendim. Ndërfaqja krijohet, administrohet dhe përditësohet nën autoritetin dhe përgjegjësinë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Çdo institucion publik krijon një llogari të vetën në NRI.
3. Llogaria në NRI krijohet personalisht nga personi përgjegjës për raportimin.
4. Për krijimin e llogarisë personi përgjegjës ngarkon në NRI, numrin e tij personal të identifikimit, datëlindjen, pozicionin që ka në strukturën administrative të institucionit publik, numër telefoni mobile, adresë e-mail, dokumentin e identifikimit të skanuar, si dhe versionin e

skanuar të autorizimit të lëshuar nga drejtuesi i institucionit publik, si person përgjegjës për raportimin.

5. Në momentin e krijimit të llogarisë në NRI personit përgjegjës i shkon në numrin e tij mobile një kod numerik për të autentifikuar kërkesën për hapjen e llogarisë përkatëse.
6. Institucioni publik është përgjegjës për të dhënat që ngarkon në NRI dhe në tërësi për mbajtjen dhe administrimin e llogarisë.

## KREU III
## PROCEDURA E RAPORTIMIT NË NRI

1. Raportimi në NRI për një veprimtari publike të caktuar duhet të bëhet jo më vonë se 5 ditë përpara datës së planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Raportimi bëhet për veprimtari të cilat organizohen, ose bashkëorganizohen nga institucioni publik raportues. Nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë.
2. NRI mund të lejojë raportimin e një veprimtarie e cila nuk plotëson kushtin e pikës 1 të këtij Kreu, por automatikisht kjo veprimtari përcaktohet si e ndaluar për sa kohë KSHZ nuk ka marrë një vendim për ta lejuar atë.
3. Raportimi duhet të përmbajë datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë, qarkun, bashkinë adresën ku ajo zhvillohet, llojin e saj, tematikën e veprimtarisë, emër mbiemër të personave pjesmarrës të cilët përfaqësojnë nivelin më të lartë hierarkik shtetëror në aktivitetin përkatës, institucionin të cilit i përkasin, emër mbiemër të folësve të mundshëm dhe pozicionin e tyre, me pjesmarrje të medias ose jo, pasqyruar në rrjete sociale, median online, ose jo.
4. Të dhënat e raportimit nuk mund të modifikohen në periudhën 5 ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit deri në datën e zhvillimit të tij.

## KREU IV
## SHQYRTIMI I RAPORTIMEVE

1. KQZ shqyrton raportimet e institucioneve si rregull jo më vonë se 3 ditë nga raportimi i tyre në NRI.
2. Në rast se KQZ, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton se veprimtaria ose aktiviteti publik përbën veprimtari të ndaluar, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë ose aktivitetit publik përkatës. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit “Ndaluar nga KQZ-ja” në NRI, në pjesën që i takon veprimtarisë. Njoftimi për ndalim i shkon automatikisht institucionit në llogarinë e tij në NRI.
3. Personat e tretë që paraqesin kërkesën në KQZ për të kërkuar ndalimin e një veprimtarie apo aktiviteti publik, duhet ta paraqesin atë jo më vonë se tre ditë nga data e planifikuar e mbajtjes së tij. Kërkesa paraqitet në protokollin e KQZ ose nëpërmjet adresës zyrtare të e-mailit dhe duhet të jetë e arsyetuar. KQZ shqyrton kërkesën dhe vendos në lidhje me të brenda 24 orësh nga paraqitja e saj.
4. Për veprimtarinë ose aktivitetin publik “Ndaluar nga KQZ-ja”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton menjëherë zyrtarisht edhe Autoritetin e Mediave Audiovizive. Veprimtaritë e ndaluara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk lejohen të transmetohen apo të pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me ndalimin e vendosur nga Komisioneri ngarkon me përgjegjësi sipas këtij ligji transmetuesin radioteleviziv.
5. Mosraportimi i një veprimtarie publike, ose raportimi i saj në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë vendim, apo akte të tjera, apo pengimi për raportim, ngarkon me përgjegjësi personi përkatës në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Shqyrtimi administrativ në këtë rast bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe aktet e KQZ.

**KREU V**
**DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimit të gjitha institucionet publike sipas përkufizimit në këtë vendim.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij akti, çdo akt nënligjor apo çdo pjesë e tij që vjen në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO Kryetar**

**Arens ÇELA Anëtar**

**Dritan ÇAKA Anëtar**

**Helga VUKAJ Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ Anëtar**